Dialogu ndërkomunitar dhe kohezioni social në Kosovë

Perceptimet, sfidat dhe perspektivat e komuniteteve joshumicë

2026



MUSINE KOKALARI
INSTITUTI PËR POLITIKA SOCIALE

NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Dialogu ndërkomunitar dhe kohezioni social në Kosovë

Perceptimet, sfidat dhe perspektivat e komuniteteve joshumicë

Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari është një institut i pavarur kërkimor (*think tank*) në Kosovë i cili promovon drejtësinë sociale, barazinë, demokracinë dhe politikat publike gjithëpërfshirëse, duke mbështetur organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë shoqërorë në hartimin, zbatimin dhe promovimin e politikave të tyre. Instituti përqendrohet në konceptimin dhe promovimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe të bazuar në sundimin e ligjit. Me një orientim drejt së ardhmes, synojmë të kapërcejmë dallimet, të zvogëlojmë hendekët shoqërorë dhe të ndërtojmë vlera të përbashkëta publike, të cilat ndahen dhe vlerësohen kolektivisht.

Mohim përgjegjësie: Ky raport është hartuar në kuadër të projektit "Nxitja e dialogut politik për kohezionin ndëretnik dhe social", me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Përgjegjësia për përmbajtjen e raportit i takon tërësisht Institutit për Politika Sociale Musine Kokalari. Pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit.

E drejta e autorit © 2026 i përket IPS Musine Kokalari. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në asnjë formë apo me asnjë mjet, qoftë elektronik, mekanik, përmes fotokopjimit, regjistrimit apo metodave të tjera, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Institutit për Politika Sociale Musine Kokalari.

Autor: **Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari**

MUSINE KOKALARI
INSTITUTI PËR POLITIKA SOCIALE

NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Adresa: Rruga B, Residio (Dervisholli),
Hyrja B, Nr. 15, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Kontakti: +383 44 752 353
info@musineinstitute.org
www.musineinstitute.org

Përmbajtja

1. Hyrje 06

2. Qëllimi dhe objektivat specifike të studimit 07

3. Metodologjia 08

4. Analiza e rezultateve 11

5. Gjetjet nga dialogët me komunitete, punëtoritë me të rinjtë dhe konsultimet lokale 20

6. Gjetje të përbashkëta nga diskutimet lokale 25

7. Gjetjet kryesore dhe përfundimet 26

8. Rekomandimet 31

9. Prioritetet strategjike 36

1. Hyrje

Gjatë muajit qershor 2026, Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari angazhoi UBO Consulting për realizimin e një ankete në kuadër të projektit "Nxitja e dialogut politik për kohezionin ndëretnik dhe social". Studimi synon të kontribuojë në një kuptim më të thelluar të përvojave dhe perceptimeve të komuniteteve joshumicë në Kosovë, duke e trajtuar kohezionin social jo vetëm në aspektin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, por edhe në raport me kushtet sociale, ekonomike dhe institucionale që ndikojnë në përfshirjen e tyre dhe në perspektivat për të ardhmen.

Anketa është realizuar me 800 qytetarë nga komunitetet joshumicë që jetojnë në Kosovë, përfshirë komunitetin serb, boshnjak, turk, rom, ashkali, egjiptian dhe goran. Përmes saj janë mbledhur të dhëna mbi perceptimet, përvojat dhe qëndrimet e respondentëve lidhur me marrëdhëniet ndëretnike dhe kohezionin social, qasjen në shërbime publike dhe sociale, të drejtat gjuhësore, trajtimin e barabartë, besimin në institucione, arsimin, punësimin, mundësitë ekonomike, pjesëmarrjen qytetare dhe perspektivat për të ardhmen.

Të dhënat nxjerrin në pah dallimet në përvojat e komuniteteve joshumicë. Ndonëse në disa fusha vërehen vlerësime relativisht pozitive për perspektivat e ardhshme dhe rëndësinë e investimeve në arsim, aftësim profesional dhe bashkëpunim ndërmjet komuniteteve, në fusha të tjera shfaqen dallime të theksuara. Në veçanti, perceptimet mbi përfshirjen, qasjen në shërbime, trajtimin e barabartë dhe aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur nevojave të komuniteteve ndryshojnë ndjeshëm. Këto dallime sugjerojnë se kohezioni social në Kosovë nuk mund të kuptohet vetëm përmes cilësisë së marrëdhënieve ndërkomunitare, por duhet të shqyrtohet edhe në raport me mundësitë reale të qytetarëve për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të marrë pjesë në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike.

Një dimension i rëndësishëm i studimit është edhe perspektiva e të rinjve dhe mundësitë që ata kanë për të ndërtuar të ardhmen në Kosovë. Për respondentët, investimet në arsim dhe aftësi profesionale, mbështetja për punësim dhe zhvillim të bizneseve të vogla, si dhe krijimi i hapësirave për pjesëmarrje dhe iniciativa të të rinjve, paraqiten si elemente të rëndësishme për përmirësimin e perspektivave të komuniteteve. Në këtë kuptim, migrimi dhe mungesa e mundësive ekonomike nuk shfaqen vetëm si çështje socioekonomike, por edhe si faktorë që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e komuniteteve dhe në kohezionin social në nivel lokal.

Në të njëjtën kohë, rezultatet evidentojnë rëndësinë e dimensionit institucional. Perceptimet për qasjen në shërbime në gjuhën e komunitetit, trajtimin e barabartë, diskriminimin dhe kuptimin e nevojave të komuniteteve ndryshojnë dukshëm, duke treguar se marrëdhënia ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve mbetet një komponent i rëndësishëm i përfshirjes sociale. Këto perceptime nuk përbëjnë në vetvete matje të rasteve të verifikuara të diskriminimit apo të performancës institucionale, por janë të rëndësishme për të kuptuar mënyrën se si qytetarët e përjetojnë qasjen në shërbime dhe raportin e tyre me institucionet.

Përveç të dhënave të mbledhura përmes anketës, studimi mbështetet edhe në gjetjet dhe diskutimet e zhvilluara gjatë aktiviteteve të projektit, përfshirë dialogun me komunitetet, punëtoritë me të rinjtë dhe takimet me asambleistë. Këto aktivitete nuk janë pjesë e mostrës së anketës, por shërbejnë si burime plotësuese për interpretimin dhe kontekstualizimin e rezultateve sasiore. Ato ndihmojnë në identifikimin e sfidave konkrete në nivel lokal, si infrastruktura dhe shërbimet bazë, transporti, punësimi, migrimi dhe mungesa e hapësirave për aktivitete qytetare e ndërveprim ndërmjet komuniteteve.

Duke ndërthurur rezultatet e anketës me perspektivat e mbledhura gjatë aktiviteteve të projektit, studimi synon të ofrojë një analizë më të plotë të faktorëve që ndikojnë në kohezionin ndëretnik dhe social në Kosovë. Gjetjet sugjerojnë se dialogu ndërmjet komuniteteve, ndonëse i domosdoshëm, nuk është i mjaftueshëm në mungesë të kushteve konkrete për përfshirje dhe barazi. Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse kërkon njëkohësisht institucione më të përgjegjshme, qasje të barabartë në të drejta dhe shërbime, mundësi për zhvillim socioekonomik dhe pjesëmarrje më kuptimplote të komuniteteve në proceset vendimmarrëse. Kjo ndërlidhje ndërmjet dialogut, barazisë dhe përgjegjësisë institucionale përbën boshtin e analizës dhe të rekomandimeve të paraqitura në këtë studim.

2. Qëllimi dhe objektivat specifike të studimit

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është të analizojë perceptimet, qëndrimet dhe përvojat e qytetarëve nga komunitetet joshumicë në Kosovë lidhur me marrëdhëniet ndëretnike, sfidat e jetës së përditshme dhe perspektivat e tyre sociale dhe ekonomike. Studimi trajton, ndër të tjera, çështjet e arsimit, punësimit, mundësive ekonomike, qasjes në shërbime publike, përfshirjes sociale dhe besimit në institucione, pjesëmarrjes qytetare dhe politike, si dhe perceptimet dhe pritshmëritë e respondentëve për perspektivat e tyre gjatë pesë viteve të ardhshme.

Një ndër synimet kryesore të anketës ishte t'u mundësonte pjesëmarrësve të shprehnin në mënyrë të lirë dhe anonime perceptimet, përvojat dhe qëndrimet e tyre. Përmes analizës së përgjigjeve, studimi synon të identifikojë nevojat dhe sfidat më të shpeshta të raportuara nga respondentët e komuniteteve joshumicë, si dhe të evidentojë dallimet dhe ngjashmëritë në perceptime ndërmjet komuniteteve dhe grupeve të ndryshme shoqërore.

Ndërsa përmes dialogut me komunitetet dhe punëtorive me të rinjtë, projekti synoi të krijojë hapësira për diskutim dhe pjesëmarrje, ku qytetarët, veçanërisht të rinjtë, të mund të shprehin më gjerësisht përvojat, shqetësimet dhe sfidat me të cilat përballen në jetën e përditshme. Këto aktivitete shërbyen gjithashtu për të identifikuar nevojat dhe prioritetet lokale, si dhe për të nxitur shkëmbimin e perspektivave mbi mundësitë për bashkëpunim dhe përfshirje më të madhe shoqërore.

Nëpërmjet takimeve me asambleistë, projekti synoi të shqyrtojë mënyrën se si përfaqësuesit e zgjedhur në nivel lokal i trajtojnë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, masat dhe iniciativat e ndërmarra në komunat përkatëse, si dhe prioritetet për përmirësimin e mirëqenies së banorëve. Njëkohësisht, këto takime synuan të kontribuojnë në një kuptim më të mirë të marrëdhënies ndërmjet përfaqësimit politik, përgjegjësisë institucionale dhe pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset vendimmarrëse.

3. Metodologjia

3.1 Qasja metodologjike

Ky studim është realizuar përmes një qasjeje kryesisht sasiore, të mbështetur në një anketë me 800 respondentë nga komunitetet joshumicë në Kosovë. Anketa ka shërbyer si burimi kryesor i të dhënave për këtë studim, me synim matjen e perceptimeve, qëndrimeve dhe përvojave të qytetarëve nga komunitetet joshumicë lidhur me marrëdhëniet ndëretnike, kohezionin social, qasjen në shërbime publike, përfshirjen sociale, arsimin, punësimin, perspektivat ekonomike dhe besimin në institucione.

Për të plotësuar të dhënat sasiore të anketës, në analizë janë përfshirë edhe gjetjet dhe diskutimet e zhvilluara gjatë dialogut me komunitetet, punëtorive me të rinjtë dhe takimeve me asambleistë. Këto të dhëna janë përdorur për të plotësuar dhe kontekstualizuar rezultatet e anketës, pa u trajtuar si pjesë e mostrës prej 800 respondentësh.

Në interpretimin e rezultateve bëhet dallim ndërmjet të dhënave të anketës, të cilat pasqyrojnë përgjigjet e respondentëve, dhe gjetjeve nga aktivitetet e dialogut dhe konsultimit, të cilat ofrojnë kontekst dhe perspektiva plotësuese. Këto të fundit nuk përdoren për të nxjerrë përfundime statistikore për komunitetet e përfshira në studim.

3.2 Mostra dhe shpërndarja e respondentëve

Mostra e studimit përfshin 800 respondentë nga shtatë komunitete joshumicë në Kosovë: serbë, boshnjakë, turq, romë, ashkalinj, egjiptianë dhe goranë.

Shpërndarja e respondentëve sipas përkatësisë komunitare paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Komuniteti	Numri i respondentëve	Pjesëmarrja në mostër
Serb	238	29.8%
Boshnjak	174	21.8%
Turk	120	15.0%
Rom	51	6.4 %
Ashkali	87	10.9 %
Egjiptian	69	8.6 %
Goran	61	7.6 %
Gjithsej	**800**	**100%**

Shënim: Përqindjet janë rrumbullakosur në një shifër dhjetore, prandaj shuma e tyre rezulton 100,1%.

Mostra ka përfshirë respondentë nga 31 komuna të Kosovës, duke marrë parasysh shpërndarjen territoriale të komuniteteve joshumicë të përfshira në studim. Kjo ka mundësuar përfshirjen e përvojave dhe perceptimeve nga kontekste të ndryshme lokale, si dhe krahasimin e rezultateve sipas përkatësisë komunitare dhe vendbanimit, aty ku madhësia e mostrës e lejon.

Numri më i madh i respondentëve është përfshirë në komunat ku përqendrimi i komuniteteve përkatëse është më i lartë. Për shembull, në komunën e Prizrenit janë përfshirë gjithsej 203 respondentë, përfshirë 116 boshnjakë, 62 turq, 12 romë, 8 ashkalinj, 1 egjiptian dhe 4 goranë. Në Graçanicë janë përfshirë 64 respondentë, prej të cilëve 55 serbë, ndërsa në Shtërpcë janë përfshirë 55 respondentë, prej të cilëve 54 serbë.

Kjo shpërndarje ka synuar të përfshijë përvojat dhe perceptimet e komuniteteve joshumicë në kontekste të ndryshme lokale, duke marrë parasysh praninë dhe shpërndarjen e tyre territoriale.

3.3 Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura përmes anketës janë analizuar në mënyrë përshkruese dhe krahasuese. Analiza ka përfshirë rezultatet për të gjithë mostrën, si dhe krahasimet ndërmjet kategorive të ndryshme të respondentëve, me qëllim identifikimin e dallimeve dhe ngjashmërive në perceptimet dhe përvojat e tyre.

Në varësi të natyrës së pyetjeve dhe të dhënave të disponueshme, rezultatet janë analizuar sipas:

- komunitetit etnik;
- komunës;
- zonës së banimit (urbane/rurale);
- gjinisë;
- grupmoshës;
- nivelit të arsimit; dhe
- statusit të punësimit.

Gjatë interpretimit të rezultateve krahasuese është marrë parasysh madhësia e grupeve të respondentëve, veçanërisht në rastet kur numri i pjesëmarrësve në kategori të caktuara ka qenë i kufizuar. Për këtë arsye, dallimet e identifikuara janë interpretuar me kujdes, duke shmangur përgjithësimet përtej të dhënave të mbledhura.

Sa i përket gjinisë, mostra paraqet një shpërndarje relativisht të balancuar. Gratë përbëjnë 50,5% të respondentëve, ndërsa burrat 49,5%.

Kjo shpërndarje mundëson krahasimin e perceptimeve dhe përvojave sipas gjinisë, veçanërisht në çështjet që lidhen me punësimin, arsimin, përfshirjen sociale, qasjen në shërbime dhe mundësitë ekonomike.

Në aspektin e moshës, grupi më i madh i respondentëve është ai i moshës 25–34 vjeç, që përbën 19,1% të mostrës. Pas tij vjen grupmosha 35–44 vjeç me 17,8%, ndërsa 17,6% e respondentëve janë të moshës 45–54 vjeç.

Përfshirja e grupmoshave të ndryshme krijon mundësi për të shqyrtuar dallimet ndërmjet brezave, veçanërisht në perceptimet mbi perspektivat për të ardhmen, arsimin, punësimin dhe marrëdhëniet me institucionet.

Sa i përket vendbanimit, 56,9% e respondentëve jetojnë në zona rurale, ndërsa 43,1% në zona urbane. Ky dallim është i rëndësishëm për analizën, pasi kushtet infrastrukturore, qasja në shërbime publike dhe mundësitë ekonomike mund të ndryshojnë ndërmjet zonave rurale dhe urbane.

Pothuajse gjysma e respondentëve, përkatësisht 47,9%, kanë përfunduar arsimin e mesëm. Arsimin fillor e kanë përfunduar 29,3% e respondentëve, ndërsa 9,4% deklarojnë se nuk kanë arsim formal. Respondentët me arsim profesional përbëjnë 5,3% të mostrës, ndërsa 7,6% kanë përfunduar arsimin universitar. Vetëm 0,5% kanë nivel pasuniversitar të arsimit.

Kjo përbërje tregon se shumica e respondentëve kanë arsim fillor ose të mesëm, ndërsa pjesëmarrja e personave me arsim të lartë është relativisht e kufizuar. Niveli i arsimit përbën një variabël të rëndësishme për interpretimin e perceptimeve mbi punësimin, aftësimin profesional dhe mundësitë ekonomike.

Në aspektin e statusit të punësimit, 37,2% e respondentëve janë të punësuar, ndërsa 22,9% deklarojnë se janë të papunë. Personat e vetëpunësuar përbëjnë 6,1% të mostrës.

Pensionistët përbëjnë 14,3%, ndërsa 14,2% deklarojnë se janë të angazhuar në punë shtëpie ose kujdes familjar pa pagesë. Studentët përbëjnë 3,6%, ndërsa 1,6% deklarojnë se angazhohen në punë sezonale ose joformale.

Këto të dhëna paraqesin një përbërje të larmishme të mostrës sipas statusit të punësimit dhe ofrojnë bazë për të analizuar lidhjen ndërmjet pozitës në tregun e punës, sigurisë ekonomike dhe perceptimeve për mundësitë e ardhshme.

Paga përbën burimin kryesor të të ardhurave për 55,9% të familjeve të respondentëve. Vetëpunësimi ose biznesi familjar përbën burimin kryesor për 6,9%, ndërsa 8,3% deklarojnë se të ardhurat kryesore vijnë nga puna sezonale ose ditore.

Pensionet janë burimi kryesor i të ardhurave për 12% të familjeve, ndërsa 8,4% mbështeten kryesisht në asistencën sociale. Për 2,3% të respondentëve, remitancat përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave, ndërsa 6,1% deklarojnë se familja e tyre nuk ka të ardhura të rregullta.

Kjo shpërndarje tregon se, krahas familjeve që mbështeten kryesisht në të ardhurat nga puna, një pjesë e respondentëve varen nga pensionet, asistenca sociale ose burime të tjera, ndërsa disa nuk kanë të ardhura të rregullta. Këto dallime janë të rëndësishme për shqyrtimin e kushteve ekonomike dhe të mundësive për përfshirje sociale.

Pjesa më e madhe e respondentëve, 78,2%, deklarojnë se në familjen e tyre nuk ka persona që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm. Megjithatë, 11,6% kanë në familje një person të moshuar që ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm, ndërsa 3,9% kanë një person me sëmundje kronike. Në 2,9% të rasteve raportohet prania e një personi me aftësi të kufizuara, ndërsa 2,1% deklarojnë se kanë në familje një fëmijë me nevoja të veçanta. Një pjesë e respondentëve, 1,3%, kanë preferuar të mos përgjigjen.

Këto të dhëna janë të rëndësishme për analizën e mëtejshme të qasjes në shërbime sociale dhe të nevojave për mbështetje, pasi një pjesë e familjeve të përfshira në studim përballen drejtpërdrejt me përgjegjësi të kujdesit të vazhdueshëm.

3.4 Përmbledhje e profilit të respondentëve

Në përgjithësi, mostra përfshin respondentë nga komunitete të ndryshme joshumicë, me karakteristika të larmishme demografike dhe socioekonomike. Më shumë se gjysma e respondentëve jetojnë në zona rurale, ndërsa shumica kanë përfunduar arsimin fillor ose të mesëm. Në aspektin e punësimit, 37,2% e respondentëve deklarojnë se janë të punësuar, ndërsa pjesa tjetër përfshin të papunë, të vetëpunësuar, pensionistë, studentë dhe persona të angazhuar në punë të papaguar familjare ose forma të tjera të punës.

Këto karakteristika demografike dhe socioekonomike përbëjnë një pikënisje të rëndësishme për interpretimin e rezultateve. Në kapitujt vijues, përmes të dhënave do të shqyrtohen dallimet dhe ngjashmëritë në perceptimet dhe përvojat e respondentëve, duke marrë parasysh përkatësinë komunitare, moshën, gjininë, vendbanimin dhe pozitën socioekonomike.

3.5 Kufizimet metodologjike të studimit

Rezultatet e këtij studimi duhet të interpretohen duke marrë parasysh disa kufizime metodologjike. Së pari, analiza mbështetet në perceptimet, qëndrimet dhe përvojat e raportuara nga respondentët, të cilat nuk përbëjnë domosdoshmërisht matje objektive të gjendjes së shërbimeve publike, nivelit të diskriminimit apo performancës institucionale.

Së dyti, madhësia e mostrës ndryshon ndërmjet komuniteteve të përfshira në studim. Për këtë arsye, krahasimet ndërmjet tyre duhet të interpretohen me kujdes, veçanërisht për komunitetet me numër më të kufizuar respondentësh. Përgjithësimi i rezultateve për popullsinë e komuniteteve përkatëse varet nga mënyra e përzgjedhjes së mostrës dhe përfaqësueshmëria e saj.

Së treti, të dhënat e mbledhura gjatë dialogëve me komunitetet, punëtorive me të rinjtë dhe konsultimeve lokale shërbejnë për kontekstualizimin e rezultateve të anketës dhe nuk mund të përgjithësohen statistikisht për komunitetet apo komunat përkatëse.

Së fundi, studimi ka karakter kryesisht përshkrues dhe krahasues. Për rrjedhojë, marrëdhëniet e mundshme ndërmjet kushteve socio-ekonomike, besimit institucional dhe kohezionit social interpretohen si lidhje analitike të sugjeruara nga gjetjet dhe jo si marrëdhënie shkakësore të verifikuara.

4

Analiza e rezultateve

4.1 Marrëdhëniet ndëretnike, kohezioni social dhe perspektiva për të ardhmen

Ky kapitull analizon perceptimet e respondentëve lidhur me të ardhmen e tyre personale dhe të komuniteteve përkatëse në Kosovë, besimin në mundësinë e ndërtimit të një shoqërie më gjithëpërfshirëse, perspektivën e të rinjve, rëndësinë e arsimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, si dhe pritshmëritë ndaj institucioneve. Rezultatet nxjerrin në pah dallime ndërmjet komuniteteve sa i përket optimizmit për të ardhmen, besimit në mundësitë për përmirësim dhe pritshmërive ndaj institucioneve.

Në mesin e respondentëve nga komunitetet turk, boshnjak dhe ashkali vërehet një prirje më e theksuar drejt optimizmit të moderuar dhe besimit në përmirësimin e kushteve të jetesës. Në mesin e respondentëve nga komunitetet rom dhe egjiptian, qëndrimet optimiste shoqërohen edhe me shqetësime lidhur me perspektivat ekonomike dhe mundësitë për të rinjtë.

Ndërkohë, respondentët nga komuniteti serb shprehin nivele më të ulëta optimizmi në disa prej dimensioneve kryesore të analizuara, përfshirë të ardhmen personale dhe atë të komunitetit, perspektivat e brezave të ardhshëm, mundësitë për një shoqëri më gjithëpërfshirëse, si dhe besimin në përmirësimin e kushteve përmes veprimit institucional. Në të njëjtën kohë, një pjesë e konsiderueshme e respondentëve të këtij komuniteti e vlerësojnë pozitivisht rëndësinë e programeve të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve.

Sa optimist/e jeni për të ardhmen tuaj personale në Kosovë?




FIGURA 01 Perceptimet e respondentëve për të ardhmen e tyre personale, sipas komunitetit

Rezultatet tregojnë gjithashtu se respondentët u japin rëndësi arsimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve si faktorë për përmirësimin e perspektivave të ardhshme, edhe kur vlerësimet për gjendjen aktuale dhe rolin e institucioneve janë më kritike. Kjo sugjeron se, pavarësisht dallimeve në nivelin e optimizmit, respondentët nga komunitete të ndryshme ndajnë disa prioritete të përbashkëta, të cilat mund të shërbejnë si bazë për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit ndërkomunitar.

Sa të rëndësishme janë programet që nxisin bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve etnike për të ardhmen e Kosovës?




FIGURA 02 Vlerësimi i rëndësisë së programeve të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve

Në tërësi, këto rezultate sugjerojnë se perspektivat për të ardhmen dhe besimi në mundësitë për përmirësimin e kushteve të jetesës përbëjnë dimensione të rëndësishme të perceptimeve mbi kohezionin social, krahas marrëdhënieve ndërkomunitare. Arsimi, mundësitë ekonomike, bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve dhe besimi në aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve përbëjnë dimensione të ndërlidhura të kohezionit social.

4.2 Punësimi dhe perspektivat ekonomike

Punësimi dhe mundësitë ekonomike përbëjnë një dimension të rëndësishëm të kushteve të jetesës dhe perspektivave për të ardhmen të komuniteteve joshumicë në Kosovë. Rezultatet e anketës nxjerrin në pah pakënaqësinë me mundësitë aktuale të punësimit, pengesat e perceptuara për qasjen në tregun e punës dhe mbështetjen për zhvillimin ekonomik.

Megjithatë, këto shqetësime shoqërohen edhe me pritshmëri relativisht pozitive për përmirësimin e situatës në të ardhmen.

Më shumë se gjysma e respondentëve (52,2%) deklarojnë se janë pak ose aspak të kënaqur me mundësitë aktuale të punësimit në komunat e tyre. Në të njëjtën kohë, 64,2% vlerësojnë se ekzistojnë të paktën mundësi të moderuara për përmirësimin e perspektivave të punësimit për brezat e rinj, ndërsa 64,1% shprehin vlerësime të ngjashme për mundësinë e përfshirjes më të madhe të komuniteteve të tyre në tregun e punës.

Këto rezultate sugjerojnë se pakënaqësia me mundësitë aktuale të punësimit nuk përjashton optimizmin e moderuar për të ardhmen, duke nxjerrë në pah dallimin ndërmjet përvojave të tanishme dhe pritshmërive për përmirësim.

Sa të kënaqur jeni me mundësitë për punësim në komunën tuaj?




FIGURA 03 Kënaqësia me mundësitë aktuale të punësimit

Një prej gjetjeve më të rëndësishme lidhet me perceptimin se përkatësia etnike mund të ndikojë në qasjen në tregun e punës. Gjithsej 64,2% e respondentëve deklarojnë se përkatësia etnike ua kufizon mundësitë e punësimit të paktën ndonjëherë. Ky rezultat sugjeron se pengesat e perceptuara në punësim nuk kanë vetëm dimension ekonomik, por lidhen edhe me çështje të trajtimit të barabartë, përfshirjes sociale dhe besimit ndërmjet komuniteteve.

Në të njëjtën kohë, rezultatet tregojnë një vlerësim të gjerë pozitiv për rëndësinë e investimeve në arsim dhe aftësim profesional. Gjithsej 83,3% e respondentëve i konsiderojnë investimet në arsimin profesional dhe aftësitë digjitale të paktën mesatarisht të rëndësishme, ndërsa 85,9% e konsiderojnë të paktën mesatarisht të rëndësishme grantet, trajnimet dhe mbështetjen për bizneset e vogla.

Megjithatë, respondentët shprehin vlerësime më të rezervuara për mbështetjen që aktualisht u ofrohet bizneseve të vogla dhe familjare. Këto rezultate tregojnë se vlerësimi i lartë i rëndësisë së mbështetjes ekonomike nuk shoqërohet domosdoshmërisht me të njëjtin nivel kënaqësie ndaj masave ekzistuese. Ky dallim sugjeron nevojën për të shqyrtuar jo vetëm disponueshmërinë, por edhe përshtatshmërinë dhe qasjen në programet mbështetëse.

Rezultatet evidentojnë gjithashtu pritshmëri relativisht pozitive lidhur me gatishmërinë e të rinjve për angazhim shoqëror dhe përmirësimin e mundësive ekonomike të grave. Sipas rezultateve të anketës, 84,2% e respondentëve vlerësojnë se të rinjtë e komunitetit të tyre janë, të paktën deri diku, të gatshëm të ndërmarrin iniciativa sociale, ndërsa 66,4% besojnë, të paktën deri diku, se mundësitë ekonomike për gratë do të përmirësohen në të ardhmen.

Në tërësi, rezultatet nxjerrin në pah tri fusha prioritare për politikat e punësimit dhe zhvillimit ekonomik: zgjerimin e mundësive për punësim, zhvillimin e aftësive profesionale dhe përmirësimin e mekanizmave të mbështetjes për sipërmarrjen dhe bizneset e vogla. Perceptimet lidhur me ndikimin e përkatësisë etnike në mundësitë e punësimit theksojnë gjithashtu rëndësinë e transparencës në procedurat e rekrutimit, trajtimit të barabartë dhe sigurimit të mundësive të qasshme për qytetarët nga të gjitha komunitetet.

52,2%

deklarojnë se janë pak ose aspak të kënaqur me mundësitë aktuale të punësimit në komunat e tyre.

↓

64,2%

vlerësojnë se ekzistojnë të paktën mundësi të moderuara për përmirësimin e perspektivave të punësimit për brezat e rinj, ndërsa **64,1%** shprehin vlerësime të ngjashme për mundësinë e përfshirjes më të madhe të komuniteteve të tyre në tregun e punës.

Sa të rëndësishme janë grantet, trajnimet dhe mbështetja për bizneset e vogla për të ardhmen ekonomike të komuniteteve




FIGURA 04 Vlerësimi i rëndësisë së granteve, trajnimeve dhe mbështetjes për bizneset e vogla

Megjithatë, këto vlerësime pasqyrojnë perceptimet dhe pritshmëritë e respondentëve dhe nuk përbëjnë matje të drejtpërdrejtë të pjesëmarrjes së të rinjve në iniciativa sociale apo të ndryshimeve në mundësitë ekonomike të grave.

4.3 Qasja në shërbime sociale

Qasja në shërbime sociale përbën një dimension thelbësor të mirëqenies dhe përfshirjes së komuniteteve joshumicë në Kosovë. Rezultatet e anketës nxjerrin në pah sfida që lidhen jo vetëm me mundësinë e përfitimit nga këto shërbime, por edhe me informimin e qytetarëve, procedurat e aplikimit për asistencë sociale dhe aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur nevojave të familjeve dhe grupeve në situata të cenueshme. Të dhënat evidentojnë gjithashtu dallime ndërmjet komuniteteve në përvojat dhe perceptimet e tyre lidhur me qasjen në këto shërbime.

Përgjigjet e respondentëve tregojnë se qasja në shërbime sociale duhet të shqyrtohet jo vetëm në raport me disponueshmërinë e tyre, por edhe me nivelin e informimit, procedurat e aplikimit dhe mundësitë e qytetarëve për t'i shfrytëzuar këto shërbime.

Një nga gjetjet më të theksuara lidhet me nivelin e informimit për shërbimet sociale. Në mesin e respondentëve nga komuniteti serb, 45.5% deklarojnë se janë aspak të informuar për shërbimet sociale në dispozicion.

84,2%

e respondentëve vlerësojnë se të rinjtë e komunitetit të tyre janë, të paktën deri diku, të gatshëm të ndërmarrin iniciativa sociale, ndërsa

66,4%

besojnë, të paktën deri diku, se mundësitë ekonomike për gratë do të përmirësohen në të ardhmen.

Sa të informuar jeni për shërbimet sociale që ofrohen nga institucionet publike?




FIGURA 05 Sa të informuar jeni për shërbimet sociale që ofrohen nga institucionet publike?

Këto vlerësime nxjerrin në pah pengesa të perceptuara në informim, aplikim dhe mbulimin e familjeve në situata të cenueshme. Ato sugjerojnë nevojën për të shqyrtuar mënyrën se si informacioni mbi shërbimet sociale u përcillet qytetarëve, sa të qasshme janë procedurat administrative dhe në çfarë mase shërbimet u përgjigjen nevojave të komuniteteve.

Një tjetër gjetje e rëndësishme është se përdorimi i shërbimeve sociale rezulton më i lartë në mesin e respondentëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, por kjo nuk shoqërohet domosdoshmërisht me vlerësime më pozitive për qasjen dhe mbulimin e tyre. Kjo tregon se përdorimi i shërbimeve sociale nuk nënkupton domosdoshmërisht se ato janë lehtësisht të qasshme apo se u përgjigjen plotësisht nevojave të përfituesve. Për këtë arsye, vlerësimi i shërbimeve duhet të marrë parasysh jo vetëm shkallën e përdorimit, por edhe përvojat e qytetarëve, pengesat në qasje dhe përshtatshmërinë e mbështetjes së ofruar.

Në tërësi, gjetjet sugjerojnë se përmirësimi i qasjes në shërbime sociale kërkon masa të koordinuara për informimin e qytetarëve, thjeshtimin e procedurave administrative dhe identifikimin e familjeve që përballen me pengesa në përfitimin e mbështetjes sociale.

4.4 Arsimi dhe shëndetësia

Arsimi dhe shëndetësia përbëjnë dy dimensione thelbësore të mirëqenies dhe përfshirjes sociale të komuniteteve joshumicë në Kosovë. Rezultatet e anketës nxjerrin në pah dallime ndërmjet komuniteteve, si në nivelin e kënaqësisë me këto shërbime, ashtu edhe në prioritetet për përmirësimin e tyre. Këto prioritete lidhen me mbështetjen financiare, transportin, kushtet infrastrukturore, pajisjet dhe barnat, disponueshmërinë e stafit, kohën e pritjes dhe trajtimin e barabartë.

Në të dy sektorët, përgjigjet e respondentëve përqendrohen kryesisht në kategorinë "deri diku të kënaqur", ndërsa nivelet e kënaqësisë së lartë mbeten më të kufizuara në disa komunitete. Shpërndarja e përgjigjeve ndryshon sipas komunitetit dhe sektorit, duke sugjeruar se përvojat e respondentëve me shërbimet arsimore dhe shëndetësore nuk janë të njëtrajtshme.

Sa i përket arsimit, respondentët nga komunitetet rom dhe boshnjak shprehin nivele relativisht më të larta të pakënaqësisë. Në shëndetësi, vlerësime më kritike shfaqen edhe në mesin e respondentëve nga komunitetet egjiptian dhe ashkali. Nga ana tjetër, respondentët nga komunitetet turk dhe ashkali shprehin vlerësime relativisht më pozitive për qasjen në arsim, ndërsa në shëndetësi vlerësimet më pozitive vërehen te respondentët nga komunitetet turk dhe goran.

Rezultatet tregojnë se vështirësitë e perceptuara në qasjen në arsim dhe shëndetësi lidhen me një sërë faktorësh që shkojnë përtej kushteve infrastrukturore. Në arsim, krahas kushteve fizike dhe transportit, respondentët theksojnë rëndësinë e mbështetjes financiare, mësimit plotësues, informimit të prindërve, trajtimit të barabartë dhe mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta.

Në shëndetësi, krahas disponueshmërisë së barnave dhe pajisjeve, si çështje të rëndësishme identifikohen koha e pritjes, mungesa e stafit, oraret e shërbimit, informimi, afërsia e institucioneve shëndetësore me vendbanimin dhe trajtimi i barabartë.

Këto rezultate sugjerojnë se përmirësimi i qasjes në shërbimet publike kërkon ndërthurjen e investimeve në kapacitete dhe infrastrukturë me masa që sigurojnë informim më të mirë dhe shërbime më të qasshme, më fleksibile dhe më të përshtatura me nevojat specifike të komuniteteve.

Dallimet në prioritetet e raportuara nga respondentët e komuniteteve të ndryshme tregojnë rëndësinë e politikave dhe ndërhyrjeve të përshtatura me nevojat dhe rrethanat e secilit komunitet, në vend të një qasjeje të njëtrajtshme për të gjithë.

4.5 Qasja në shërbime publike, gjuhësore dhe digjitale

Qasja në shërbime publike për komunitetet joshumicë përfshin jo vetëm disponueshmërinë e shërbimeve, por edhe mundësinë e përdorimit të tyre në gjuhët përkatëse, trajtimin e barabartë dhe shmangien e pengesave që mund të lidhen me përkatësinë komunitare. Në këtë kuadër, anketa shqyrton qasjen në shërbime administrative dhe digjitale, perceptimet për diskriminimin dhe trajtimin e barabartë, si dhe vlerësimet e respondentëve mbi aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur nevojave të komuniteteve.

Analiza përqendrohet në pesë dimensione të ndërlidhura: qasjen në shërbime në gjuhët e komuniteteve, qasjen në shërbimet digjitale, trajtimin e barabartë, perceptimet për diskriminimin dhe vlerësimet mbi aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur nevojave të komuniteteve.

Sa i përket qasjes gjuhësore, respondentët nga komuniteti serb shprehin vlerësimet më kritike ndër komunitetet e përfshira në anketë: gjithsej 61,2% e tyre i konsiderojnë shërbimet administrative në gjuhën e komunitetit pak ose aspak të qasshme.

Sa u përket shërbimeve digjitale, vlerësimet e respondentëve janë përgjithësisht më të moderuara, por dallimet ndërmjet komuniteteve mbeten të dukshme. Respondentët nga komunitetet serb dhe rom raportojnë më shpesh vështirësi në qasjen në këto shërbime.

Sa të qasshme janë shërbimet administrative në gjuhën tuaj?




FIGURA 06 Vlerësimi i qasshmërisë së shërbimeve administrative në gjuhët e komuniteteve

Një nga dallimet më të theksuara ndërmjet respondentëve të komuniteteve të ndryshme lidhet me perceptimin për trajtimin e barabartë në ofrimin e shërbimeve. Ndërsa respondentët nga shumica e komuniteteve e vlerësojnë trajtimin si të barabartë të paktën deri diku, 75,3% e respondentëve nga komuniteti serb konsiderojnë se trajtimi është pak ose aspak i barabartë. Në mënyrë të ngjashme, 54,3% e respondentëve nga ky komunitet vlerësojnë se diskriminimi në ofrimin e shërbimeve sociale ndodh shpesh ose shumë shpesh.

Këto rezultate pasqyrojnë perceptimet e respondentëve mbi trajtimin institucional dhe nuk përbëjnë në vetvete matje të rasteve të verifikuara të diskriminimit.

Sa të barabartë mendoni se trajtohet komuniteti juaj në ofrimin e shërbimeve?




FIGURA 07 Perceptimet e respondentëve për trajtimin e barabartë në ofrimin e shërbimeve publike

Një tjetër tregues i rëndësishëm lidhet me vlerësimin e aftësisë së institucioneve për të kuptuar nevojat e komuniteteve. Në këtë drejtim, 82,3% e respondentëve serbë vlerësojnë se institucionet i kuptojnë pak ose aspak nevojat e komunitetit të tyre. Në krahasim me përgjigjet e respondentëve nga komunitetet e tjera, kjo gjetje sugjeron një nivel më të theksuar të distancës së perceptuar ndërmjet respondentëve serbë dhe institucioneve publike.

Në tërësi, gjetjet tregojnë se përmirësimi i qasjes në shërbime publike kërkon masa që shkojnë përtej zgjerimit të kapaciteteve dhe disponueshmërisë së shërbimeve. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet respektimit të të drejtave gjuhësore, përmirësimit të komunikimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, sigurimit të trajtimit të barabartë dhe zvogëlimit të pengesave në përdorimin e shërbimeve digjitale.

Pritshmëritë e respondentëve për përmirësimin e shërbimeve publike mbeten të ndryshme, duke përfshirë si vlerësime optimiste, ashtu edhe pasiguri për ndryshimet e mundshme në të ardhmen. Për këtë arsye, krahas përmirësimit të cilësisë dhe qasshmërisë së shërbimeve, institucionet duhet të forcojnë komunikimin me qytetarët, duke ofruar informacion të qartë dhe të qasshëm mbi shërbimet ekzistuese, procedurat e përdorimit të tyre dhe masat e planifikuara për përmirësim.

5. Gjetjet nga dialogët me komunitete, punëtoritë me të rinjtë dhe konsultimet lokale

Përveç të dhënave të mbledhura përmes anketës me 800 respondentë nga komunitetet joshumicë në Kosovë, studimi mbështetet edhe në gjetjet dhe diskutimet e zhvilluara gjatë aktiviteteve të dialogut me komunitetet, punëtorive me të rinjtë dhe konsultimeve lokale. Këto aktivitete kanë ndihmuar në identifikimin dhe kuptimin më të thelluar të sfidave të përditshme, prioriteteve dhe pritjeve të qytetarëve në kontekste të ndryshme lokale. Në veçanti, diskutimet e zhvilluara në Dragash dhe në Mitrovicën e Veriut kanë nxjerrë në pah se kohezioni social dhe marrëdhëniet ndërkomunitare nuk mund të trajtohen të shkëputura nga kushtet ekonomike, shërbimet publike, infrastruktura, mundësitë për të rinjtë dhe hapësirat për ndërveprim ndërmjet komuniteteve.

Dragash: zhvillimi lokal, migrimi dhe qasja në shërbime

Gjatë diskutimeve në Dragash, pjesëmarrësit identifikuan një sërë sfidash infrastrukturore, ekonomike dhe mjedisore që, sipas tyre, kufizojnë zhvillimin lokal dhe qasjen në shërbimet bazë. Infrastruktura dhe lidhjet rajonale u identifikuan si ndër problemet më të rëndësishme.

Gjendja e rrugëve, veçanërisht lidhja me Prizrenin dhe lidhjet ndërmjet zonave të Gorës dhe Opojës, u përmendën si pengesa për qarkullimin, punësimin dhe qasjen në shërbime. Në zonat rurale, shqetësime të ngjashme u ngritën edhe për furnizimin me ujë, energji elektrike dhe internet. Përmbytjet dhe investimet e pamjaftueshme në menaxhimin e ujërave u përmendën si probleme të përsëritura, ndërsa menaxhimi i mbeturinave dhe numri i madh i deponive ilegale u identifikuan si sfida të rëndësishme mjedisore.

Sipas pjesëmarrësve, këto probleme infrastrukturore ndikojnë edhe në perspektivat ekonomike të komunës. Papunësia, veçanërisht te të rinjtë me arsimim të lartë, u përshkrua si një nga sfidat kryesore. Pjesëmarrësit theksuan se mundësitë e punësimit në ekonominë lokale mbeten të kufizuara dhe të përqendruara kryesisht në ndërtimtari, bujqësi të vogël dhe blegtori. Mungesa e industrisë dhe e kapaciteteve për zhvillimin e bizneseve të vogla kufizon mundësitë për krijimin e vendeve të reja të punës. Në diskutim u ngrit edhe çështja e kufizimeve që lidhen me statusin e zonave të mbrojtura dhe parkut kombëtar, të cilat, sipas pjesëmarrësve, ndikojnë në mundësitë për investime private dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike.

Pjesëmarrësit e identifikuan migrimin e të rinjve si një nga sfidat kryesore për të ardhmen e komunës, duke e lidhur atë me mundësitë e kufizuara ekonomike dhe profesionale. Pjesëmarrësit folën për një largim të konsiderueshëm të të rinjve, veçanërisht nga komuniteti goran, ndërsa shumë banorë jetojnë në Prizren dhe udhëtojnë për punë atje. Sipas pjesëmarrësve, këto zhvillime ndikojnë në jetën ekonomike dhe shoqërore të komunës, duke ndryshuar edhe mënyrën e banimit dhe të aktivitetit ekonomik në nivel lokal. Në këtë kontekst, diaspora shihet si një potencial i rëndësishëm për investime dhe zhvillim lokal, por ky potencial aktualisht mbetet i kufizuar në mungesë të mekanizmave më të qëndrueshëm për përfshirjen e saj në ekonominë lokale.

Një tjetër grup shqetësimesh lidhet me qasjen në shërbime publike. Në fushën e shëndetësisë u theksua mungesa e disa shërbimeve bazike, përfshirë gjinekologjinë dhe pediatrinë, duke bërë që qytetarët të referohen në Prizren për shërbime të caktuara. Në arsim u ngrit nevoja për një qendër të mirëfilltë për fëmijët nën moshën gjashtëvjeçare në komunitetin goran, si dhe për shkolla profesionale dhe programe të edukimit praktik. Profesione si saldimi, ndërtimtaria dhe rrobaqepësia u përmendën si fusha ku ekziston nevojë për aftësim praktik, me qëllim përafrimin e ofertës arsimore me nevojat e tregut lokal të punës.

Ndarja e sistemit arsimor sipas komuniteteve dhe mungesa e mësimit të gjuhëve të komuniteteve të tjera u identifikuan si barriera për ndërveprimin ndërkomunitar. Megjithatë, pjesëmarrësit nuk raportuan konflikte të drejtpërdrejta ndërmjet komuniteteve dhe e përshkruan bashkëjetesën si përgjithësisht të qëndrueshme. Këto gjetje sugjerojnë se mungesa e konflikteve të hapura nuk nënkupton domosdoshmërisht ndërveprim të zhvilluar ndërmjet komuniteteve. Në këtë kontekst, forcimi i kohezionit social kërkon krijimin e më shumë mundësive për kontakte dhe aktivitete të përbashkëta arsimore, kulturore dhe sportive.

Gjatë diskutimit u ngritën edhe shqetësime lidhur me sfidat sociale dhe demografike, mungesa e hapësirave të përshtatshme për pensionistët dhe pjesëmarrja e kufizuar e grave dhe vajzave në jetën publike dhe sportive. Pjesëmarrësit përmendën gjithashtu raste të martesave të hershme në disa komunitete. Këto pohime pasqyrojnë shqetësime të ngritura gjatë diskutimit dhe nuk mund të përgjithësohen për komunitetet përkatëse në tërësi. Mungesa e aktiviteteve të rregullta kulturore dhe sportive, veçanërisht për vajzat, u konsiderua si një pengesë për pjesëmarrjen dhe ndërveprimin social.

Krahas sfidave, pjesëmarrësit identifikuan edhe mundësi për zhvillimin ekonomik lokal. Bujqësia dhe blegtoria u konsideruan sektorë me potencial nëse organizohen dhe mbështeten më mirë, ndërsa turizmi dhe mbledhja e bimëve të imëta u përmendën si mundësi shtesë për zhvillim ekonomik. Megjithatë, potenciali turistik i Dragashit konsiderohet i shfrytëzuar në mënyrë të pamjaftueshme për shkak të mungesës së infrastrukturës, shërbimeve bazike dhe mbështetjes institucionale. Në këtë kuadër, u ngrit edhe nevoja për rishikimin e disa rregullave dhe kufizimeve që lidhen me zonat e mbrojtura, me qëllim që të gjendet një ekuilibër ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal.

Në tërësi, diskutimet në Dragash nxjerrin në pah ndërlidhjen ndërmjet sfidave ekonomike, mangësive infrastrukturore, qasjes në shërbime dhe mundësive për ndërveprim ndërkomunitar. Sipas pjesëmarrësve, mundësitë e kufizuara për punësim, vështirësitë në qasjen në shërbime dhe migrimi i të rinjve përbëjnë sfida që ndikojnë në perspektivat e zhvillimit lokal dhe në jetën shoqërore të komuniteteve. Këto gjetje sugjerojnë se forcimi i kohezionit social në Dragash kërkon një qasje që ndërthur përmirësimin e kushteve të jetesës, zhvillimin ekonomik dhe krijimin e hapësirave për bashkëpunim e ndërveprim të rregullt ndërmjet komuniteteve.

Mitrovica e Veriut: komunikimi ndërkomunitar, të rinjtë dhe hapësirat e përbashkëta

Diskutimi i zhvilluar në Mitrovicën e Veriut më 19 maj 2026, me pjesëmarrës nga komunitetet boshnjak, serb dhe shqiptar, u përqendrua në bashkëjetesën, sfidat e komunikimit ndërmjet komuniteteve, perspektivën e të rinjve dhe rolin e institucioneve lokale. Një nga temat kryesore të diskutimit ishte vështirësia për të trajtuar tema të caktuara, veçanërisht ato politike, të cilat, sipas pjesëmarrësve mund të krijojnë tensione ndërmjet komuniteteve dhe grupmoshave të ndryshme. Në këtë kontekst, u shpreh një lloj lodhjeje nga temat politike dhe një nevojë për t'u përqendruar më shumë në problemet konkrete që prekin jetën e përditshme.

Gjuha u identifikua si një nga barrierat kryesore në komunikimin ndërmjet komuniteteve dhe në marrëdhënien e tyre me institucionet. Nga diskutimi rezultoi se, sipas pjesëmarrësve, distanca ndërmjet komuniteteve lidhet jo vetëm me dallimet politike, por edhe me pengesat gjuhësore dhe vështirësitë e komunikimit të përditshëm.

Për komunitetin serb u përmend edhe një dimension tjetër i kësaj problematike: afrimi ose komunikimi më i madh me komunitetin shqiptar mund të perceptohet negativisht nga një pjesë e komunitetit, duke krijuar presion social dhe duke e bërë më të vështirë ndërtimin e marrëdhënieve të hapura ndërkomunitare. Ky shqetësim pasqyron përvojat dhe perceptimet e shprehura nga pjesëmarrësit dhe nuk duhet të përgjithësohet për komunitetin serb në tërësi.

Përkundër këtyre barrierave, pjesëmarrësit identifikuan edhe elemente të përbashkëta që mund të shërbejnë si bazë për afrimin e komuniteteve. Në veçanti, aktivitetet kulturore dhe sportive u përmendën si hapësira të mundshme për ndërveprim, sidomos për të rinjtë. Pjesëmarrësit vunë në dukje se fëmijët nga komunitete të ndryshme kanë mundësi të ndërveprojnë në hapësira të përbashkëta, si fushat sportive, por sipas tyre, këto mundësi mbeten të kufizuara dhe janë më të pranishme në zonat urbane.

Perspektiva e të rinjve ishte një tjetër shqetësim qendror. Mungesa e vendeve të punës dhe perspektivave profesionale lokale u konsiderua si një faktor që nxit migrimin dhe ndikon në të ardhmen e qytetit. U përmendën raste të të rinjve që përfundojnë arsimin, përfshirë edhe studime profesionale si mjekësia, por përballen me mungesë të mundësive për punësim. Këto përvoja sugjerojnë se sfidat e të rinjve nuk kufizohen vetëm në qasjen në arsim, por lidhen edhe me mundësitë për të gjetur punësim dhe për të zhvilluar karrierën profesionale në nivel lokal.

Pjesëmarrësit e lidhën gjithashtu perspektivën e të rinjve me mënyrën se si formohen qëndrimet dhe perceptimet e tyre. Komunikimi brenda familjes dhe idetë politike me të cilat të rinjtë rriten u përmendën si faktorë që mund të ndikojnë në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit theksuan se ndërveprimi spontan i fëmijëve në aktivitete të përbashkëta mund të krijojë mundësi për kontakte ndërkomunitare që shkojnë përtej ndarjeve ekzistuese.

Në këtë drejtim, roli i institucioneve lokale u konsiderua i rëndësishëm. Pjesëmarrësit shprehën pritje që komuna të krijojë më shumë mundësi për aktivitete kulturore dhe sportive, veçanërisht për të rinjtë. Mungesa e sallave sportive u përmend si një problem konkret, ndërsa investimi në hapësira të tilla u pa si një mënyrë për të nxitur ndërveprimin ndërkomunitar. Pjesëmarrësit ngritën gjithashtu shqetësimin se idetë dhe propozimet për iniciativa lokale nuk gjejnë gjithmonë rrugë për t'u shqyrtuar nga institucionet. Kjo nxjerr në pah nevojën për mekanizma më funksionalë të komunikimit, konsultimit dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen lokale.

Gjatë diskutimit u ngritën gjithashtu shqetësime për mundësitë e kufizuara ekonomike, veçanërisht për gratë dhe vajzat. Mungesa e vendeve të punës dhe e aktiviteteve ekonomike u lidh me transformimin e hapësirave dhe kapaciteteve prodhuese lokale pas luftës. Në këtë kontekst, u përmend mbyllja e një fabrike të materialeve dhe mungesa e alternativave të ngjashme. Për gratë dhe vajzat u evidentua një pjesëmarrje e kufizuar në aktivitetet ekonomike dhe publike, ndërsa shërbimet e parukerisë u përmendën si një nga veprimtaritë profesionale më të zakonshme.

Në tërësi, diskutimi në Mitrovicën e Veriut sugjeron se përmirësimi i marrëdhënieve ndërkomunitare nuk varet vetëm nga dialogu politik, por edhe nga kushtet konkrete të jetesës dhe mundësitë për ndërveprim të përditshëm. Pjesëmarrësit e lidhën forcimin e këtyre marrëdhënieve me mundësitë për punësim, hapësirat e përbashkëta publike, aktivitetet kulturore dhe sportive, komunikimin në gjuhët e komuniteteve dhe krijimin e mekanizmave që u mundësojnë qytetarëve, veçanërisht të rinjve, të komunikojnë me institucionet lokale dhe të përfshihen në propozimin dhe zhvillimin e iniciativave lokale.

6. Gjetje të përbashkëta nga diskutimet lokale

Diskutimet me asambleistët në komunat e Graçanicës, Istogut, Fushë Kosovës dhe Lipjanit nxorën në pah sfida të përbashkëta që lidhen me përfaqësimin e komuniteteve joshumicë, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe zbatimin e prioriteteve lokale. Ndonëse ekzistojnë mekanizma formalë për konsultim dhe përfaqësim, ndikimi i tyre varet nga mundësitë për t'i përfshirë kërkesat e komuniteteve në planet dhe buxhetet komunale.

Një nga shqetësimet e përbashkëta të ngritura gjatë diskutimeve lidhej me vështirësitë për t'i shndërruar nevojat dhe prioritetet e identifikuara në masa konkrete institucionale. Në Graçanicë, pjesëmarrësit theksuan se plani lokal i veprimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kërkon rishikim dhe mbështetje financiare për zbatim, veçanërisht në fushën e arsimit. Në Istog, u ngritën shqetësime për kufizimet buxhetore, vështirësitë në avancimin e propozimeve të asambleistëve dhe nevojën për përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës lokale.

Arsimi dhe mundësitë për të rinjtë përbënin një tjetër temë të rëndësishme. Diskutimet evidentuan nevojën për të nxitur vijimin e shkollimit, për të ofruar mbështetje për familjet, për të përmirësuar transportin e nxënësve dhe për të krijuar mundësi për mësimin e gjuhëve dhe ndërveprimin ndërmjet komuniteteve. Në Graçanicë u diskutua edhe mundësia e krijimit të hapësirave arsimore shumëetnike, duke marrë parasysh pengesat shoqërore dhe politike që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e familjeve.

Sa u përket shërbimeve publike dhe infrastrukturës, pjesëmarrësit identifikuan nevoja për investime në rrugë, ndriçim publik, transport, çerdhe dhe hapësira rekreative, si dhe për përmirësimin e qasjes së personave me aftësi të kufizuara në këto shërbime dhe hapësira. Në Lipjan u përmendën nevojat e lehonave për shërbime të specializuara, ndërsa në Fushë Kosovë u ngritën çështje që lidhen me përfshirjen e fëmijëve në arsim, planifikimin e shërbimeve dhe pronësinë e tokës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet.

Në përgjithësi, diskutimet sugjerojnë se përfshirja e komuniteteve nuk sigurohet vetëm përmes përfaqësimit formal apo konsultimeve publike. Ajo kërkon financim të qëndrueshëm, koordinim institucional dhe mekanizma që garantojnë se kërkesat e komuniteteve përkthehen në masa konkrete. Përmirësimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje, qasja në shërbime dhe investimet në arsim e infrastrukturë mbeten elemente të rëndësishme për forcimin e përfshirjes sociale dhe kohezionit në nivel lokal.

7. Gjetjet kryesore dhe përfundimet

7.1 Gjetjet kryesore

Rezultatet e studimit nxjerrin në pah ndërthurjen e sfidave sociale, ekonomike dhe institucionale që pasqyrohen në përvojat dhe perceptimet e respondentëve nga komunitetet joshumicë në Kosovë, si në vlerësimin e gjendjes aktuale, ashtu edhe në pritshmëritë e tyre për të ardhmen.

Në disa fusha, respondentët shprehin pritshmëri pozitive për të ardhmen, ndërsa në të tjera evidentohen pasiguri dhe pakënaqësi lidhur me gjendjen aktuale. Vlerësime veçanërisht kritike shfaqen në mesin e respondentëve nga komuniteti serb, sidomos në çështjet që lidhen me marrëdhënien me institucionet dhe qasjen në shërbime. Në tërësi, shqetësimet kryesore të identifikuara përfshijnë mundësitë e punësimit, respektimin e të drejtave gjuhësore, qasjen në shërbime publike, trajtimin e barabartë dhe perspektivat e të rinjve, përfshirë shqetësimet lidhur me migrimin.

01 Perspektivat për të ardhmen ndryshojnë ndjeshëm ndërmjet komuniteteve

Një nga gjetjet më të dukshme të studimit është dallimi në perceptimet për të ardhmen. Respondentët nga komuniteti serb shprehin nivele më të larta të pesimizmit në disa prej dimensioneve kryesore të analizuara, përfshirë perspektivat personale dhe ato të komunitetit, mundësitë për të rinjtë, përfshirjen sociale dhe aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur nevojave të tyre.

Në anën tjetër, respondentët nga komunitetet boshnjak, turk, rom, ashkali, egjiptian dhe goran shfaqin në përgjithësi pritshmëri më pozitive ose më të moderuara për të ardhmen. Megjithatë, edhe në mesin e respondentëve nga këto komunitete, optimizmi nuk duhet të interpretohet si mungesë e problemeve, pasi shqetësimet për punësimin, shërbimet publike, migrimin dhe mundësitë për të rinjtë mbeten të pranishme.

Këto dallime sugjerojnë se politikat për forcimin e kohezionit social duhet të marrin parasysh përvojat, nevojat dhe pritshmëritë e ndryshme të komuniteteve, në vend që të mbështeten në një qasje të njëtrajtshme. Po ashtu, ato nxjerrin në pah rëndësinë e përshtatjes së ndërhyrjeve me rrethanat specifike të secilit komunitet dhe me kontekstin lokal.

02 Ekziston një hendek ndërmjet nevojës për përfshirje dhe përvojës me institucionet

Një nga temat që përsëritet në disa pjesë të studimit është distanca e perceptuar ndërmjet qytetarëve nga komunitetet joshumicë dhe institucioneve publike. Në veçanti, respondentët nga komuniteti serb shprehin nivele më të ulëta besimi në aftësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur nevojave të tyre. Kjo shoqërohet me vlerësime më kritike për trajtimin e barabartë, qasjen në shërbime në gjuhën e komunitetit dhe aftësinë e institucioneve për të kuptuar nevojat e qytetarëve.

Kjo gjetje është e rëndësishme sepse sugjeron se përfaqësimi dhe përfshirja formale e komuniteteve nuk garantojnë domosdoshmërisht pjesëmarrje kuptimplote dhe trajtim të barabartë në praktikë. Përfshirja duhet të reflektohet edhe në përvojat konkrete të qytetarëve, përmes qasjes në shërbime, komunikimit me institucionet dhe mundësive reale për të ndikuar në vendimmarrje.

Ekzistojnë mekanizma institucionalë në nivel lokal për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve, por efektiviteti i tyre duhet të vlerësohet edhe përmes aftësisë për t'iu përgjigjur nevojave konkrete të qytetarëve dhe për të kontribuar në forcimin e besimit institucional.

03 Punësimi është një nga faktorët kryesorë që ndikon në perspektivat e komuniteteve

Punësimi del si një nga temat më të rëndësishme në të gjithë studimin. Vetëm 47,8% e respondentëve deklaro-

jnë se janë të paktën deri diku të kënaqur me mundësitë e punësimit në komunën e tyre, ndërsa 52,2% shprehin pakënaqësi me këto mundësi.

Në të njëjtën kohë, pritshmëritë për të ardhmen janë relativisht më pozitive: 64,2% vlerësojnë se ekzistojnë të paktën mundësi të moderuara për përmirësimin e perspektivave të punësimit të brezave të rinj. Kjo sugjeron një dallim ndërmjet pakënaqësisë me gjendjen aktuale dhe pritshmërive për përmirësim në të ardhmen.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me ndikimin e perceptuar të përkatësisë etnike në qasjen në punësim. Gjithsej 64,2% e respondentëve vlerësojnë se përkatësia etnike e kufizon qasjen në punësim të paktën ndonjëherë, ndërsa 26,5% konsiderojnë se kjo ndodh shpesh ose shumë shpesh. Këto vlerësime nuk përbëjnë dëshmi për raste të verifikuara të diskriminimit, por nxjerrin në pah rëndësinë e forcimit të barazisë së mundësive dhe transparencës në procedurat e punësimit.

04 Investimi në aftësi dhe mbështetja ekonomike shihen si prioritete të qarta

Rezultatet tregojnë një vlerësim gjerësisht pozitiv të rëndësisë së arsimit profesional, aftësive digjitale dhe mbështetjes për bizneset e vogla. Rreth 83,3% e respondentëve e konsiderojnë të paktën mesatarisht të rëndësishëm investimin në arsim profesional dhe aftësi digjitale, ndërsa 85,9% e konsiderojnë të paktën mesatarisht të rëndësishme grantet, trajnimet dhe mbështetjen për bizneset e vogla.

Megjithatë, 31,5% e respondentëve e vlerësojnë mbështetjen ekzistuese për bizneset e vogla dhe familjare si aspak ose pak të përshtatshme. Kjo sugjeron se, krahas zhvillimit të politikave të reja, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe përshtatshmërisë dhe mundësive të qasjes në mekanizmat ekzistues të mbështetjes.

Gjetjet nga Dragashi ofrojnë një ilustrim konkret të këtyre sfidave. Sipas pjesëmarrësve në diskutimet lokale, mundësitë ekonomike janë të kufizuara, bizneset e vogla përballen me mungesë kapacitetesh dhe investimet e reja mbeten të pamjaftueshme. Në këtë kontekst, forcimi i lidhjes ndërmjet arsimit profesional, nevojave të tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik lokal paraqitet si një prioritet i rëndësishëm.

05 Të rinjtë janë në qendër të sfidave dhe mundësive të forcimit të kohezionit social

Të rinjtë shfaqen në studim si një grup që përballet me sfida të rëndësishme, por edhe si një burim potencial për ndryshim dhe angazhim shoqëror.

Rreth 68,5% e respondentëve vlerësojnë se të rinjtë nga komuniteti i tyre kanë të paktën deri diku mundësi për të gjetur punë të qëndrueshme, ndërsa 84,2% i konsiderojnë të rinjtë të paktën deri diku të gatshëm për të ndërmarrë iniciativa sociale. Megjithatë, diskutimet lokale sugjerojnë se gatishmëria për angazhim nuk shoqërohet gjithmonë me mundësi konkrete për punësim dhe pjesëmarrje. Në Mitrovicën e Veriut u theksua mungesa e vendeve të punës për të rinjtë e arsimuar, ndërsa në Dragash migrimi i të rinjve u identifikua si një nga sfidat kryesore për të ardhmen e komunës.

Në të dyja rastet u evidentua edhe mungesa e hapësirave për aktivitete kulturore dhe sportive. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për forcimin e kohezionit social, pasi ndërveprimi ndërkomunitar nuk duhet të kufizohet vetëm në format e organizuara të dialogut. Hapësirat sportive, kulturore, arsimore dhe komunitare mund të mundësojnë kontakte të rregullta dhe ndërveprim më spontan ndërmjet të rinjve nga komunitete të ndryshme.

06 Arsimi dhe gjuha mbeten faktorë kyç për ndërveprimin ndërkomunitar

Investimi në arsim vlerësohet si prioritet nga një pjesë e madhe e respondentëve. Në të njëjtën kohë, diskutimet lokale sugjerojnë se organizimi i sistemit arsimor dhe mundësitë e kufizuara për mësimin e gjuhëve të komuniteteve të tjera mund të pengojnë ndërveprimin ndërkomunitar.

Në Dragash u theksua ndarja e sistemit arsimor sipas komuniteteve dhe mungesa e mësimit të gjuhëve të komuniteteve të tjera. Në Mitrovicën e Veriut, gjuha u identifikua si një nga pengesat kryesore në komunikimin ndërmjet komuniteteve dhe në marrëdhëniet me institucionet.

Kjo sugjeron se mësimi i gjuhëve nuk duhet të trajtohet vetëm si çështje arsimore, por edhe si mjet për lehtësimin e komunikimit, qasjes në shërbime dhe forcimin e besimit ndërkomunitar. Përmirësimi i zbatimit të të drejtave gjuhësore dhe krijimi i mundësive për të mësuar gjuhët e komuniteteve të tjera janë gjithashtu të rëndësishme për një shoqëri më gjithëpërfshirëse.

07 Qasja në shërbime sociale paraqet dallime të ndjeshme ndërmjet komuniteteve

Gjetjet për shërbimet sociale nxjerrin në pah se një nga pengesat kryesore lidhet me nivelin e informimit të qytetarëve. Nivele të ulëta të informimit janë veçanërisht të dukshme në disa komunitete, ndërsa në mesin e përdoruesve të shërbimeve vërehen dallime të rëndësishme në perceptimin e lehtësisë së qasjes.

Respondentët nga komuniteti serb shprehin vlerësime veçanërisht kritike lidhur me informimin, procedurat e aplikimit për asistencë sociale, qasjen e familjeve në situata të cenueshme në shërbime dhe mbështetjen për personat me nevoja të veçanta.

Kjo sugjeron se qasja në shërbime nuk përcaktohet vetëm nga ekzistenca formale e një shërbimi, por edhe nga informimi, procedurat, gjuha, distanca dhe aftësia e institucioneve për të identifikuar nevojat dhe për t'iu përgjigjur atyre.

Këto gjetje theksojnë nevojën për përmirësimin e informimit, thjeshtimin e procedurave dhe zhvillimin e shërbimeve sociale më të qasshme dhe më të përshtatura me nevojat e komuniteteve.

08 Qasja në arsim dhe shëndetësi karakterizohet nga nevoja dhe përvoja të ndryshme ndërmjet komuniteteve

Rezultatet e studimit nxjerrin në pah dallime ndërmjet komuniteteve joshumicë në nivelin e kënaqësisë me shërbimet arsimore dhe shëndetësore, si dhe në prioritetet e identifikuara për përmirësimin e tyre.

Në arsim, shqetësimet e respondentëve lidhen me kushtet infrastrukturore, transportin, mbështetjen financiare, mësimin plotësues dhe trajtimin e barabartë. Në shëndetësi, si çështje të rëndësishme identifikohen disponueshmëria e barnave dhe pajisjeve, mungesa e stafit, koha e pritjes, afërsia e shërbimeve me vendbanimin dhe trajtimi i barabartë.

Këto gjetje sugjerojnë se përmirësimi i qasjes në arsim dhe shëndetësi kërkon masa të përshtatura me nevojat e komuniteteve dhe rrethanat lokale, duke ndërthurur investimet në infrastrukturë dhe kapacitete me përmirësimin e cilësisë, qasshmërisë dhe trajtimit të barabartë në ofrimin e shërbimeve.

09 Të drejtat gjuhësore dhe trajtimi i barabartë janë dimensione thelbësore të përfshirjes sociale

Të dhënat për shërbimet publike tregojnë se gjuha është një nga dimensionet më të rëndësishme të përvojës së qytetarëve me institucionet. Në mesin e respondentëve nga komuniteti serb, 61,2% e konsiderojnë qasjen në shërbime administrative në gjuhën e tyre pak ose aspak të mjaftueshme. Në të njëjtën kohë, 75,3% e respondentëve serbë vlerësojnë se trajtimi në ofrimin e shërbimeve është pak ose aspak i barabartë.

Këto perceptime nxjerrin në pah rëndësinë e zbatimit të të drejtave gjuhësore dhe sigurimit të trajtimit të barabartë në praktikë. Ato sugjerojnë gjithashtu se mënyra se si qytetarët e përjetojnë marrëdhënien me institucionet mund të ketë ndikim në besimin institucional dhe në ndjenjën e përfshirjes sociale.

10 Digjitalizimi ofron potencial, por nuk e zëvendëson nevojën për përfshirje të barabartë

Shërbimet digjitale vlerësohen relativisht më pozitivisht krahasuar me disa aspekte të tjera të qasjes në shërbime publike, por dallimet ndërmjet komuniteteve mbeten të dukshme. Në mesin e respondentëve nga komunitetet serb dhe rom, një pjesë e konsiderueshme e tyre e konsideron qasjen në shërbime digjitale pak ose aspak të lehtë.

Kjo sugjeron se digjitalizimi mund të lehtësojë qasjen në shërbime, me kusht që të shoqërohet me ofrimin e shërbimeve në gjuhët e komuniteteve, zhvillimin e aftësive

digjitale dhe mbështetjen e qytetarëve që hasin vështirësi në përdorimin e platformave online. Përndryshe, digjitalizimi rrezikon të krijojë pengesa të reja dhe të thellojë pabarazitë ekzistuese në qasjen në shërbime.

11 Marrëdhëniet ndërkomunitare janë përgjithësisht të qëndrueshme në disa kontekste lokale, por mundësitë për ndërveprim mbeten të kufizuara

Gjetjet nga Dragashi dhe Mitrovica e Veriut sugjerojnë se mungesa e konflikteve të drejtpërdrejta nuk nënkupton domosdoshmërisht një nivel të lartë të kohezionit social.

Në Dragash, bashkëjetesa u përshkrua si e qëndrueshme dhe nuk u raportuan konflikte të hapura ndërmjet komuniteteve, por u identifikuan pengesa të rëndësishme gjuhësore dhe arsimore, si dhe mundësi të kufizuara për aktivitete të përbashkëta.

Në Mitrovicën e Veriut, pjesëmarrësit folën për distancën e perceptuar ndërmjet komuniteteve, ndjeshmërinë ndaj temave politike dhe mungesën e hapësirave ku të rinjtë mund të ndërveprojnë rregullisht. Kjo sugjeron se vlerësimi i kohezionit social nuk duhet të kufizohet vetëm te mungesa e konflikteve, por duhet të marrë parasysh edhe mundësitë për kontakt të rregullt, bashkëpunim, ndërtim të besimit dhe pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta.

12 Gratë dhe vajzat përballen me mundësi të kufizuara për pjesëmarrje sociale dhe ekonomike

Rezultatet e anketës nxjerrin në pah pritshmëri relativisht pozitive për përmirësimin e mundësive ekonomike të grave: 66,4% e respondentëve besojnë, të paktën deri diku, se gratë nga komuniteti i tyre do të kenë më shumë mundësi ekonomike në të ardhmen.

Megjithatë, diskutimet lokale nxorën në pah pengesa që kufizojnë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në jetën publike, sportive dhe ekonomike. Në Dragash u përmend mungesa e aktiviteteve të rregullta për vajzat, ndërsa në Mitrovicën e Veriut u evidentuan mundësi të kufizuara ekonomike dhe përqendrimi i veprimtarive ekonomike të grave në një numër të kufizuar profesionesh.

Kjo sugjeron se përmirësimi i mundësive ekonomike dhe pjesëmarrjes sociale të grave kërkon masa që shkojnë përtej trajnimeve të përgjithshme dhe që lehtësojnë qasjen në punësim, financim dhe sipërmarrje, si dhe krijojnë më shumë mundësi për pjesëmarrje në jetën publike dhe në proceset vendimmarrëse.

13 Migrimi është një tregues i rëndësishëm i mundësive të kufizuara për të ardhmen

Migrimi i të rinjve është një nga temat që lidh gjetjet e anketës me shqetësimet e ngritura gjatë diskutimeve lokale. Në Dragash, migrimi u përshkrua nga pjesëmarrësit si një dukuri e përhapur, me pasoja të mundshme për strukturën demografike të komunës. Në Mitrovicën e Veriut, mungesa e mundësive për punësim dhe zhvillim profesional në nivel lokal u identifikua si një nga faktorët që mund të nxisin largimin e të rinjve.

Kjo sugjeron se përballja me sfidat e migrimit nuk mund të kufizohet vetëm te masat që synojnë t'i nxisin të rinjtë të qëndrojnë në vend. Përmirësimi i perspektivave të tyre kërkon krijimin e mundësive konkrete për punësim, zhvillimin e arsimit dhe aftësimit profesional, përmirësimin e shërbimeve publike dhe krijimin e hapësirave për angazhim dhe pjesëmarrje aktive në jetën lokale.

7.2 Përfundimi

Në tërësi, studimi sugjeron se kohezioni social në Kosovë nuk mund të forcohet vetëm përmes dialogut ndërmjet komuniteteve ose përmes aktiviteteve të përqendruara ekskluzivisht në marrëdhëniet ndëretnike. Ai lidhet ngushtë me kushtet e jetesës, qasjen e barabartë në shërbime, mundësitë për punësim dhe arsimim, respektimin e të drejtave gjuhësore dhe pjesëmarrjen kuptimplote të qytetarëve në vendimmarrje.

Një nga përfundimet kryesore të studimit është se perceptimet për kohezionin social duhet të analizohen në raport me kushtet socio-ekonomike, përvojat me institucionet dhe mundësitë për ndërveprim ndërkomunitar. Mundësitë e kufizuara për punësim, vështirësitë në qasjen në shërbimet publike, mungesa e hapësirave të përbashkëta dhe ndjenja e mospërfshirjes në vendimmarrje mund të dobësojnë besimin te institucionet dhe të zbehin perspektivat për të ardhmen, duke ndikuar edhe në prirjet për migrim.

Në të njëjtën kohë, të dhënat nxjerrin në pah prioritete të përbashkëta që mund të shërbejnë si bazë për politika më gjithëpërfshirëse. Një pjesë e madhe e respondentëve e vlerëson rëndësinë e arsimit, bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, aftësive profesionale, mbështetjes ekonomike dhe iniciativave të të rinjve. Kjo sugjeron se, pavarësisht dallimeve ndërmjet komuniteteve, ekzistojnë mundësi për zhvillimin e iniciativave të përbashkëta, me kusht që institucionet të krijojnë hapësira dhe mekanizma të besueshëm për pjesëmarrje dhe bashkëpunim.

Prandaj, forcimi i kohezionit social kërkon një qasje që shkon përtej ndërhyrjeve të izoluara dhe afatshkurtra, duke i ndërlidhur politikat sociale, ekonomike dhe institucionale me nevojat konkrete të komuniteteve dhe me veçoritë e konteksteve lokale. Kjo kërkon bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet institucioneve qendrore, komunave dhe shoqërisë civile, si dhe përfshirjen aktive të vetë komuniteteve në përcaktimin e prioriteteve dhe në proceset vendimmarrëse. Në këtë kuptim, kohezioni social duhet të trajtohet jo vetëm si objektiv i dialogut ndërkomunitar, por edhe si rezultat i politikave publike që forcojnë barazinë e mundësive, besimin institucional dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën shoqërore dhe institucionale.

8. Rekomandimet

Gjetjet sugjerojnë se forcimi i kohezionit social kërkon kalimin nga ndërhyrjet e fragmentuara drejt politikave të koordinuara që ndërlidhin pjesëmarrjen qytetare, qasjen e barabartë në shërbime, punësimin, zhvillimin lokal dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve. Për këtë arsye, rekomandimet në vijim fokusohen jo vetëm në zgjerimin e programeve ekzistuese, por edhe në krijimin e mekanizmave institucionalë që mundësojnë zbatimin dhe monitorimin e politikave, si dhe forcimin e llogaridhënies.

8.1 Për institucionet lokale – komunat

01 Të institucionalizohet pjesëmarrja e komuniteteve në planifikimin dhe buxhetimin komunal

Komunat duhet të krijojnë mekanizma të rregullt për përfshirjen e komuniteteve joshumicë në hartimin e politikave, planeve zhvillimore dhe buxheteve komunale. Konsultimet duhet të zhvillohen përpara miratimit të dokumenteve kryesore dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e grave, të rinjve dhe grupeve të cenueshme.

Për të shmangur konsultimet thjesht formale, komunat duhet të publikojnë, pas çdo procesi konsultativ, një përmbledhje të propozimeve të pranuara, të refuzuara ose të planifikuara për zbatim, së bashku me arsyetimin përkatës.

02 Të forcohen mekanizmat komunalë për komunitete dhe ndërlidhja e tyre me vendimmarrjen

Zyrat komunale për komunitete dhe kthim, komitetet për komunitete dhe mekanizmat e tjerë përfaqësues duhet të kenë burime njerëzore dhe financiare të mjaftueshme, si dhe kompetenca të qarta e kapacitete të nevojshme për identifikimin dhe adresimin e problemeve të komuniteteve.

Komunat duhet të krijojnë procedura të rregullta përmes të cilave çështjet e identifikuara nga këta mekanizma t'u përcillen drejtorive kompetente dhe të monitorohet mënyra e trajtimit të tyre. Rezultatet e këtij procesi duhet t'u komunikohen edhe përfaqësuesve të komuniteteve.

03 Të garantohet qasja efektive në shërbimet komunale në gjuhët përkatëse

Komunat duhet të kryejnë vlerësime periodike të respektimit të të drejtave gjuhësore në ofrimin e shërbimeve administrative, dokumentacionin publik, formularët, faqet elektronike, platformat digjitale dhe komunikimin me qytetarët.

Mangësitë e identifikuara duhet të përfshihen në plane konkrete përmirësimi, me përgjegjësi institucionale dhe afate të përcaktuara. Zbatimi i këtyre planeve duhet të monitorohet dhe rezultatet të bëhen publike.

04 Të zhvillohet një qasje proaktive ndaj shërbimeve sociale

Informimi rreth shërbimeve sociale nuk duhet të mbështetet vetëm në kërkesën individuale të qytetarëve. Komunat dhe Qendrat për Punë Sociale duhet të zhvillojnë mekanizma proaktivë për identifikimin dhe informimin e familjeve dhe individëve që rrezikojnë të mbeten jashtë sistemit të mbrojtjes sociale.

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet zonave rurale, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, familjeve me të ardhura të ulëta dhe komuniteteve joshumicë. Informacioni duhet të ofrohet në gjuhët përkatëse dhe përmes kanaleve që përdoren në praktikë nga komunitetet.

05 Të krijohet një infrastrukturë rinore që nxit ndërveprimin ndërmjet komuniteteve

Investimet komunale në qendra rinore, aktivitete sportive dhe kulturore, biblioteka dhe hapësira publike duhet të shihen edhe si instrumente për forcimin e kohezionit social.

Një pjesë e programeve komunale për të rinjtë duhet të synojë në mënyrë të qartë nxitjen e ndërveprimit ndërmjet të rinjve nga komunitete të ndryshme. Komunat duhet gjithashtu të krijojnë skema të vogla financimi për iniciativa të ideuara dhe të zbatuara nga vetë të rinjtë.

06 Të lidhen politikat rinore me punësimin dhe zhvillimin ekonomik lokal

Programet komunale për të rinjtë duhet të hartohen duke u bazuar në analizën e nevojave të tregut lokal të punës. Komunat duhet të krijojnë partneritete me bizneset, shkollat profesionale dhe ofruesit e trajnimeve për të ofruar mundësi për praktikë profesionale, mentorim, orientim në karrierë dhe aftësim profesional.

Në komunat me ekonomi kryesisht rurale, përfshirë Dragashin, programet duhet të orientohen edhe drejt sektorëve ku ekziston potencial real për zhvillim, si bujqësia, blegtoria, përpunimi ushqimor, turizmi dhe shërbimet.

07 Të hiqen pengesat ndaj pjesëmarrjes ekonomike dhe publike të grave

Politikat komunale për fuqizimin e grave, veçanërisht të atyre nga komunitetet joshumicë dhe zonat rurale, duhet të shkojnë përtej trajnimeve të përgjithshme.

Mbështetja duhet të përfshijë mundësi për qasje në financim, mentorim, tregje, rrjete biznesi dhe programe për formalizimin ose zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Gratë duhet gjithashtu të përfshihen në mënyrë sistematike në konsultimet dhe mekanizmat lokalë të vendimmarrjes.

08 Të integrohet migrimi në politikat e zhvillimit lokal

Komunat me nivele të larta të migrimit duhet të analizojnë rregullisht shkaqet lokale të largimit, veçanërisht mungesën e mundësive për punësim, qasjen e kufizuar në shërbime dhe mungesën e perspektivës për të rinjtë.

Këto analiza duhet të pasqyrohen në planet e zhvillimit ekonomik lokal dhe në politikat për punësim, aftësim profesional dhe investime. Diaspora duhet të përfshihet përmes mekanizmave konkretë për investime, transferimin e njohurive dhe krijimin e lidhjeve me bizneset lokale.

09 Të përdoren investimet në infrastrukturë si instrument për forcimin e kohezionit territorial dhe social

Prioritetet e investimeve komunale duhet të bazohen edhe në shkallën e përjashtimit territorial në qasjen në shërbime. Zonat me qasje të kufizuar në transport, ujësjellës, kanalizim, menaxhimin e mbeturinave, internet dhe shërbime publike duhet të identifikohen dhe të kenë përparësi në planifikimin e investimeve kapitale.

Në këtë mënyrë, infrastruktura duhet të trajtohet jo vetëm si çështje teknike, por edhe si instrument për zvogëlimin e pabarazive territoriale dhe sociale.

8.2 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

01 Të ndërlidhen arsimi dhe aftësimi profesional me nevojat reale të tregut të punës

Qeveria duhet të forcojë lidhjen ndërmjet arsimit profesional, programeve të aftësimit dhe nevojave të tregut të punës. Planifikimi i programeve duhet të mbështetet në të dhëna për profesionet dhe aftësitë e kërkuara dhe të përfshijë në mënyrë aktive të rinjtë dhe komunitetet joshumicë.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndërthurjes së aftësive profesionale dhe digjitale me përvojën praktike në vendin e punës.

02 Të vendosen objektiva të matshme për përfshirjen në programet e punësimit

Programet dhe masat aktive të tregut të punës duhet të monitorohen sipas gjinisë, moshës, komunës dhe, aty ku është e lejuar me ligj dhe metodologjikisht e mundshme, përkatësisë komunitare.

Qëllimi nuk duhet të jetë vetëm rritja e numrit të pjesëmarrësve në programe, por edhe sigurimi i kalimit të tyre drejt punësimit formal, si dhe monitorimi i qëndrueshmërisë së këtij punësimi pas përfundimit të mbështetjes.

03 Të forcohet zbatimi dhe monitorimi i të drejtave gjuhësore

Qeveria duhet të sigurojë kapacitete të mjaftueshme për përkthim dhe interpretim, si dhe të monitorojë rregullisht respektimin e detyrimeve gjuhësore nga institucionet publike.

Çdo platformë e re digjitale publike duhet të parashikojë ofrimin e shërbimeve në gjuhët përkatëse që në fazën e projektimit, në vend që përkthimi të shtohet vetëm pas zhvillimit të shërbimit.

04 Të forcohen mekanizmat e koordinimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal

Për politikat që kërkojnë zbatim të përbashkët – veçanërisht në fushën e shërbimeve sociale, punësimit, arsimit dhe të drejtave të komuniteteve – duhet të përcaktohen qartë përgjegjësitë e nivelit qendror dhe atij lokal.

Koordinimi duhet të përfshijë objektiva, tregues të matshëm të performancës, raportim periodik dhe mekanizma për adresimin e problemeve të identifikuara gjatë zbatimit. Ky koordinim duhet të mbështetet, sa është e mundur, në mekanizmat ekzistues institucionalë, duke shmangur krijimin e strukturave paralele.

05 Të sigurohet financim i qëndrueshëm dhe standarde minimale për shërbimet sociale

Decentralizimi i shërbimeve sociale duhet të shoqërohet me burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, standarde minimale për ofrimin e shërbimeve dhe monitorim të rezultateve.

Sistemi duhet të jetë në gjendje të identifikojë jo vetëm përfituesit ekzistues, por edhe individët dhe familjet që kanë nevojë për mbështetje, por që, për shkak të pengesave administrative, territoriale, gjuhësore ose mungesës së informacionit, mbeten jashtë sistemit të shërbimeve sociale.

06 Të krijohen instrumente të diferencuara për zhvillimin e komunave me nivele të larta të migrimit

Politikat kombëtare të zhvillimit ekonomik duhet të marrin parasysh dallimet territoriale. Komunat me nivele të larta të migrimit dhe të papunësisë, si dhe me një bazë të dobët ekonomike, duhet të kenë qasje në instrumente të përshtatura për zhvillimin e bizneseve të vogla, bujqësisë, ekonomisë rurale, turizmit dhe sektorëve me potencial lokal.

Mbështetja duhet të ndërlidhet me objektiva të matshme për punësim dhe zhvillim ekonomik lokal.

07 Të forcohet kontributi i diasporës në zhvillimin ekonomik lokal përmes investimeve dhe transferimit të njohurive

Politikat për diasporën duhet të krijojnë instrumente që lehtësojnë investimet produktive, partneritetet me bizneset lokale, mentorimin profesional dhe transferimin e njohurive.

Masat duhet të synojnë veçanërisht komunat me nivele të larta të emigrimit dhe potencial ekonomik të pashfrytëzuar.

08 Të mbështetet mësimi i gjuhëve dhe ndërveprimi i qëndrueshëm ndërmjet komuniteteve

Qeveria duhet të mbështesë programe afatgjata për mësimin e gjuhëve të komuniteteve të tjera, veçanërisht në mesin e të rinjve.

Programet duhet të ndërthurin mësimin e gjuhës me aktivitete të përbashkëta arsimore, kulturore dhe rinore, në mënyrë që njohuritë gjuhësore dhe ndërveprimi social të zhvillohen paralelisht.

09 Të integrohet perspektiva e grave nga komunitetet joshumicë në politikat ekonomike

Programet kombëtare të punësimit, aftësimit profesional dhe sipërmarrjes duhet të identifikojnë dhe adresojnë pengesat specifike me të cilat përballen gratë nga komunitetet joshumicë dhe zonat rurale.

Politikat duhet të ndërthurin aftësimin profesional me mundësitë për qasje në financim, tregje, mentorim, rrjete profesionale dhe masa që lehtësojnë pjesëmarrjen në tregun e punës.

9. Prioritetet strategjike

Rekomandimet mund të përmblidhen në gjashtë prioritete strategjike, të cilat duhet të udhëheqin politikat qendrore dhe lokale për forcimin e kohezionit social.

1. Barazi reale në qasjen në shërbime publike

Garantimi i qasjes së barabartë në shërbime sociale, administrative dhe shërbime të tjera publike, pavarësisht nga vendbanimi, gjuha, gjinia apo përkatësia komunitare.

2. Punësim, zhvillim lokal dhe zvogëlim i pabarazive territoriale

Ndërlidhja e arsimit dhe aftësimit profesional me nevojat e tregut të punës, mbështetja e ekonomive lokale dhe orientimi i investimeve drejt zonave me mundësi më të kufizuara ekonomike dhe nivele më të larta të migrimit.

3. Të rinjtë si aktorë të zhvillimit dhe kohezionit social

Kalimi nga trajtimi i të rinjve vetëm si përfitues të politikave drejt përfshirjes së tyre si bashkëhartues dhe zbatues të iniciativave lokale, duke ndërlidhur punësimin, arsimin, kulturën, sportin dhe ndërveprimin ndërkomunitar.

4. Arsimi, gjuha dhe ndërveprimi social si ura ndërmjet komuniteteve

Zgjerimi i mundësive për mësimin e gjuhëve të komuniteteve të tjera, krijimi i hapësirave të përbashkëta arsimore dhe mbështetja e ndërveprimit të vazhdueshëm ndërmjet qytetarëve të moshave dhe komuniteteve të ndryshme.

5. Përfaqësim dhe pjesëmarrje me ndikim real në vendimmarrje

Mekanizmat e konsultimit dhe përfaqësimit duhet të kalojnë nga pjesëmarrja formale drejt ushtrimit të një ndikimi të matshëm në hartimin e politikave, përcaktimin e buxheteve dhe proceset vendimmarrëse. Kjo vlen veçanërisht për komunitetet joshumicë, gratë, të rinjtë dhe grupet e cenueshme.

6. Qeverisje e koordinuar dhe llogaridhënie për kohezionin social

Kohezioni social duhet të trajtohet si objektiv ndërsektorial dhe jo si një fushë e kufizuar vetëm në politikat për komunitetet. Kjo kërkon koordinim ndërmjet Qeverisë, komunave dhe shoqërisë civile, përcaktim të qartë të përgjegjësive, financim të qëndrueshëm dhe tregues të matshëm për vlerësimin e rezultateve.

Në këtë kuptim, forcimi i kohezionit social kërkon që barazia e mundësive, qasja në shërbime, siguria ekonomike dhe pjesëmarrja në vendimmarrje të trajtohen si përgjegjësi të përbashkëta të institucioneve qendrore, komunave dhe shoqërisë civile. Objektivi i politikave publike duhet të jetë krijimi i kushteve në të cilat përkatësia komunitare, gjuha, gjinia apo vendbanimi nuk përcaktojnë mundësitë e qytetarëve për punësim, arsimim, qasje në shërbime dhe pjesëmarrje në jetën publike. Në këtë mënyrë, kohezioni social shndërrohet nga një objektiv i dialogut ndërkomunitar në një përgjegjësi konkrete të qeverisjes dhe të politikave publike.



